



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË**  
**PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

Nr. 22 Akti  
Dt. 18.03.2022

Nr. 22 Vendimi  
Dt. 26.03.2022

**SHKURTIM VENDIMI**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë prej:

**GJYQTARE - IRENA GJOKA**

asistuar nga sekretare gjyqësore Bora Totolaku, sot me datë 26.03.2022, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, kërkesën penale me nr. 22 Akti që i përket:

**KËRKUES:** Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar në paraqitjen e kërkesës nga **prokurori Dritan Prenci**.

**OBJEKTI:** I.Caktimin e masave të sigurimit personal shtërngues “Arresti në burg” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale

**NDAJ PERSONAVE NËN HETIM:**

**1. Lefter Koka** i biri i Haki-ut dhe i Hajrës, i datëlindjes 04.08.1964, lindur dhe banues në Durrës, me gjendje civile të bashkuar me kombësi dhe shtetësi shqiptare.

**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale”, kryer në rrethanën cilësuese “në bashkëpunim”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 248 e 25, 260 e 25, 287/1, gërma “a” dhe “b” dhe 278/2 të Kodit Penal.

**2. Pëllumb Abeshi,**

**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal.

**3. Azem Shatëri,**

**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal.

**4. Florjan Muçaj**

**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim,

parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal.

**5. Erjon Murataj,**

**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal.

**6. Klodian Zoto,**

**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale”, kryer në rrethanën cilësuese “në bashkëpunim”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 245 e 25 dhe 287/1, gërma “a” dhe “b” dhe 278/2 të Kodit Penal.

**7. Arenc Myrtezani,**

**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale”, kryer në rrethanën cilësuese “në bashkëpunim”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 245 e 25 dhe 287/1, gërma “a” dhe “b” dhe 278/2 të Kodit Penal.

**II.**Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “Arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj personave nën hetim:

**8. Sabina Cenameri,**

**E DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal.

**9. Etleva Kondi,**

**E DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 228, 229, 230, 237, 238 244/1 të K.Pr.Penale.

Gjykata, në dhomë këshillimi pasi shqyrtoi kërkesën, mori provat dhe aktet e paraqitura nga prokurori, si dhe pasi vlerësoi çështjen në tërësi, bazuar në nenet 112/2, 228, 229, 230, 232, pika 1 gërmat “d” dhe “dh”, 237, 238, 244, 245, 249 dhe 466 të Kodit të Procedurës Penale;

**V E N D O S I**

**I.**Pranimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

1. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “**arrest në burg**”, e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Lefter Koka,**

**i dyshuar:** për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale”, kryer në rrethanën cilësuese “në bashkëpunim”,



8. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “**arrest në shtëpi**”, e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj shtetases nën hetim **Sabina Cenameri**, e bija e Hysni-ut dhe e Elida-s, e datëlindjes 09.11.1988, lindur dhe banues në Tiranë, me gjendje civile beqare, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, e **dyshuar**: për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal.
9. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “**arrest në shtëpi**”, e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj shtetases nën hetim **Etleva Kondi**

: për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal.

- II. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të ekzekutojë vendimin e gjykatës, nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- III. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brënda 5 ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke filluar ky afat nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

**U shpall në Tiranë, sot më datë 26.03.2022**

**SEKRETARE**

**BORA TOTOLAKU**

**GJYQTARE**

**IRENA GJOKA**